

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Muli xheloz për flamingon e ri nga Pekaj
ADRESA	https://www.gazetatema.net/antena/muli-xheloz-per-flamingon-e-ri-nga-pekaj-i586320
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:21:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:19:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e92d136a7764936ba4b88d1a21e11c93198104105ecdb1576a44ca63111a06d2
TEKSTI	46e9b36d12456767a242f3e2e4c0fb913608ad9dbd9477b94b896020420358e4
PAMJA	320f68e66f350a4691344e3481b3007dc8c3b084188546d1dc04dc2b679ea299

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1c34b6fd34d285966567b8b2e5117c2e4646f5520f526e2c8cdc851593676253
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bcdc39124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1c34b6fd34d285966567b8b2e5117c2e4646f5520f526e2c8cdc851593676253>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



1 e fundit [Muli xheloz per flamingon e ri nga Peka](#)[Gjykata Supreme ne Brazil shqyrton kerkesen e Shqiperise per Ervin Maten/ 'Drite jeshile' per ekstradimin e tij](#)[Erika nga tensor](#)

Muli xheloz për flamingon e ri nga Peka



15 Shtator 2026, 19:19Antena TEMA

Muli sot ishte në dilema të mëdha. Çim Peka i kishte dalë një hap para. Ai djali që shau Edi Ramën duke zbritur nga avioni ishte kushëri i Çim Pekës.

Sapo kishte thirrur Lelon të bënin një deklaratë të fortë për shtyp, u pre.

– Qenka kushëri i Çim Pekës, tha. Na e ka bërë kastile.

– Po le të jetë, tha Lelo. Ne duhet ta përgëzojmë për gjestin e tij luftarak.

– E ka bërë kastile Çimi, t'i tregojë Doktorit që po sakrifikojnë edhe familjarisht gjithë fisi Peka dhe të më zëvendësojnë mua me një nga ata.

– Nuk besoj, tha Lelo. Ata kanë iniciativë personale si fis. Unë madje kam më shumë dyshime që ai e ka bërë për t'ia dhjesë Çimit, të bëhet më i njohur se ai. Se, meqë janë tre xhaxhallarë, vetëm nga ky xhaxha nuk ishte bërë njeri i njohur. Tek dy të tjerët janë shquar.

– Mund të jetë edhe kjo, tha Muli. Por kam frikë se do ta përdorë kundër meje. Do të thotë: “Pse asnjë kushëri i Mulit nuk ka sulmuar Ramën?”. Dhe do të shpallin një dëshmor në fis.

– Ja të shikojmë, tha Lelo. Të mos nxitohemi njëherë. Por unë dyshoj se ai e ka bërë më shumë se është xheloz për Çimin, sesa Çimi për ty. Plus, kur ka marrë vesh që Çimi ka shkuar te Trumpi dhe ka marrë përgjimet, që pastaj ky ia ka dhënë Ben Ahmetajt t'i lexojë, është bërë shumë xheloz.

– Pse, kështu thotë? – tha Muli.

– Po, patjetër. Versioni i fundit është që Trumpi nuk ia prish dot Netanjahut dhe e sulmon me përgjime bashkëpunëtorët e tij, duke ia dhënë Çim Pekës, që ky t'ia japë Ben Ahmetajt, dhe kështu të formohet një gurgule që të mos merret vesh që i ka shitur Trumpi.

– Qenka e thellë puna, tha Muli. Po vazhdoi edhe pak kjo punë, do të dalë që edhe takimi i Doktorit me Trumpin nuk lejohet të shfaqet në ekran deri javën e zgjedhjeve, që ta kemi si surprizë.

– Patjetër, tha Lelo. Ajo ka filluar të besohet pa e thënë akoma.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

[Muli zbulon enigmën e dështimit të mitingut të diasporës](#)

16:36 Antena / 2 komente

Muli organizon pritjen e Doktorit në Rinas

16:34 Antena / 1 koment

[Zbulohet enigma pse Doktor i takoi shefin e Medicare në SHBA](#)

17:51 Antena / 1 koment

[Muli ngarkon Lelon të zgjidhë konfliktin mes Cimit dhe Belos](#)

18:35 Antena / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.